

VENDIM
Nr. 1, datë 16.1.2025

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 234, datë 25.10.2024, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 ‘Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH’”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 1, datë 16.1.2025 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, Dosje përpunimi nr. 1501, në ngarkim të S. A., me dy volume në total me 319 (treqind e nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1968–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, Dosje përpunimi nr. 3488, në ngarkim të P. B., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, Dosje formulare nr. 2873, në ngarkim të S. N., me 212 (dyqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Huajt, Dosje formulare nr. 2677, në ngarkim të L. M., me 87 (tetëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1949–1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Fashikull nr. 3282, në ngarkim të V. Q., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1989. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 11, “Sillogu Vorio-Epiriot Follorinë”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1968–1989. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nën objekti “Sillogu Vorio-Epiriot i Kosturit”, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1985. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 12 “Sillogu Vorio-Epiriot Selanik”, me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1990. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

9. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 8 “Sillogu Vorio-Epiriot Korfuz”, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1966–1989. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

10. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 14 “Shoqata të ndryshme krahinore të lidhura me Organizatën e Vorio-Epirit”, me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1966–1989. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 7 “Sillogu Vorio-Epiriot Athinë-Pire”, me 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1990. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 9 “Sillogu Vorio-Epiriot në Janinë”, me 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1965—1990. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje “Sillogu Vorio-Epiriot në Francë-Egjypt-Argjentinë-Australi”, me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1985. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

14. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Dosje përpunimi nr. 2366, në ngarkim të R. E., dhe fashikull personal për të dënuar, në total me 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1967-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

15. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnje, Dosje përpunimi nr. 463, në ngarkim të I. S., me 215 (dyqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1959-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

16. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Dosje formulare nr. 3398, në ngarkim të S. J., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958—1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

17. Arkiva e Autoritetit, Fondi i Veçantë, Dosje personale dhe pune nr. 6276, “Sportisti” në ngarkim të P. P., në total me 132 (njëqind e tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1982—1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

18. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Fashikull nr. 2680/67, në ngarkim të P. P., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981—1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

19. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Fashikull nr. 2365, në ngarkim të T. H., me 104 (njëqind e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1944—1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

20. Arkiva e Autoritetit, Fondi Kosova, Dosje fashikullore nr. 6765, në ngarkim të M. M., me 25 (njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1948—1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gentiana Sula